FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 6	Prill	2000

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8579, datë 16.2.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit	195
Ligj nr.8580, datë 17.2.2000	Për partitë politike	207
Ligj nr.8581, datë 17.2.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet 8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999 dhe nr.8552, datë 18.11.1999	213
Ligj nr.8582, datë 23.2.2000	Për një shtesë në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë"	216
Ligj nr.8583, datë 1.3.2000	Për disa ndryshime dhe një shtesë në ligjin nr.8388, datë 5.8.1998 "Për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake"	217

Ligj nr.8589, datë 20.3.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e emergjencës për riparimin e rrugëve"	218
Dekret nr.2524, datë 17.1. 2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	225
Vendim i KM Nr.51, datë 17.2.2000	Për një shtesë në vendimin nr.248, datë 25.3.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit dhe kategorisë së telefonave celularë, në përdorim të institucioneve buxhetore"	226
Vendim i KM Nr.61, datë 24.2.2000	Për miratimin e programit të ristrukturimit dhe të përgatitjes për privatizim të shoqërisë anonime "Instituti i Sigurimeve"	227
Vendim i KM Nr.64, datë 24.2.2000	Për krijimin e sektorit të policisë, për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake	229
Vendim i KM Nr.65, datë 24.2.2000	Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 9.9.1999 " Për privatizimin me tender të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë–Krujë"	230
Vendim i KM Nr.66, datë 24.2.2000	Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore	231
Vendim i KM Nr.77, datë 2.3.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.775, datë 28.10.1996, të Këshillit të Ministrave,"Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit"	233
Vendim i KM Nr.90, datë 24.2.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për pajisjen me pasaporta diplomatike dhe shërbimi" dhe të vendimit nr.81, datë 18.2.1999, të Këshillit të Ministrave	234
Vendim i KM Nr.96, datë 9.3.2000	Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve	235
Vendim i KM Nr.121, datë 18.3.2000	Për një shtesë në vendimin nr.581, datë 8.12.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të ofertave, për privatizimin e shoqërisë anonime "AMC"	235

LIGJ
Nr. 8579, datë 16.2.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E ARTISTËVE INTERPRETUES DHE EKZEKUTUES, TË PRODHUESVE TË FONOGRAMAVE DHE TË ORGANIZMAVE TË RADIODIFUZIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogramave dhe të organizmave të radiodifuzionit", nënshkruar në Romë, më 26 tetor 1961.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2565, datë 28.2.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA E ROMËS; 1961

KONVENTË NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E ARTISTËVE INTERPRETUES OSE EKZEKUTUES, TË PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE DHE TË ORGANIZMAVE TË RADIOFUZIONIT

Bërë në Romë, më 26 tetor 1961

Vendet kontraktuese, me dëshirën për të mbrojtur të drejtat e artistëve interpretues ose ekzekutues, të prodhuesve të fonogramave dhe të organizmave të radiodifuzionit,kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Mbrojtja e të drejtës së autorit

(Shënim: titujt u janë vënë neneve me qëllim që të lehtësohet identifikimi. Teksti i nënshkruar nuk përmban tituj.)

Mbrojtja e parashikuar në Konventën aktuale lë të pacënuar dhe nuk prek në asnjë mënyrë mbrojtjen e të drejtës së autorit mbi veprat letrare dhe artistike. Për pasojë asnjë dispozitë e Konventës aktuale nuk mund të interpretohet sikur cënon këtë mbrojtje.

Neni 2

Mbrojtja e akorduar nga Konventa. Përcaktimi i trajtimit kombëtar

1. Sipas qëllimeve të Konventës aktuale, me trajtim kombëtar kuptojmë trajtimin që vendi kontraktues në territorin e të cilit është kërkuar mbrojtja, u akordon sipas legjislacionit të tij kombëtar:

a) artistëve interpretues ose ekzekutues, që janë shtetas të huaj të tij, për ekzekutimet që kryhen, janë fiksuar për herë të parë ose janë shpërndarë në territorin e tij;

b) prodhuesve të fonogrameve që janë shtetas të huaj të tij, për fonogramet që janë publikuar ose fiksuar për herë të parë në territorin e tij;

c) organizmave të radioshpërndarjes që kanë selinë e tyre sociale në territorin e tyre, për emisionet e shpërndara nëpërmjet shpërndarësve të vendosur në këtë territor.

2. Trajtimi kombëtar do të akordohet duke mbajtur parasysh mbrojtjen e garantuar dhe kufizimet e parashikuara në Konventën aktuale.

Neni 3

Përcaktime: a) artistët interpretues ose ekzekutues; b) fonogram; c) prodhues i fonogramave; d) botimi; e) përhapja e radiofuzionit; g) ripërhapja

Sipas qëllimeve të Konventës aktuale, me "artistë interpretues ose ekzekutues" kuptojmë:

a) aktorët, këngëtarët, muzikantët, kërcimtarët dhe persona të tjerë të cilët prezantojnë, këndojnë, recitojnë, deklamojnë, luajnë ose ekzekutojnë në çfarëdo lloj mënyre tjetër, vepra letrare ose artistike;

b) "fonogram", çdo fiksim zanor i tingujve që vijnë nga një ekzekutim ose të tjerë tinguj;

c) "prodhues të fonogrameve", personin fizik ose moral, i cili fikson i pari tingujt që vijnë nga një ekzekutim ose tinguj të tjerë;

d) "botimin", vënien në dispozicion të publikut të ekzemplarëve të një fonogrami në sasi të mjaftueshme;

e) "riprodhimin" realizimin e një ose disa ekzemplarëve të një fiksimi;

f) "përhapjen e radiodifuzionit", shpërndarjen e tingujve ose të figurave dhe të tingujve me anë të valëve radioelektrike, me qëllim të marrjes së tyre nga publiku,

g) "rishpërndarjen", shpërndarjen e menjëhershme nga një organizëm i radioshpërndarjes të një emisioni, të një organizmi tjetër të radiodifuzionit.

Neni 4

Ekzekutimet e mbrojtura. Kriteret e bashkimit për artistët

Çdo vend kontraktues do t'u akordojë trajtim kombëtar artistëve interpretues ose ekzekutues çdo herë që do të përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) ekzekutimi kryhet në një vend tjetër kontraktues;

b) ekzekutimi është regjistruar mbi një fonogram të mbrojtur sipas nenit 5 të mëposhtëm;

c) ekzekutimi i pafiksuar mbi fonogram është shpërndarë nga një emsion i mbrojtur sipas nenit 6.

Neni 5

Fonogramet e mbrojtura: 1. Kriteret e bashkimit për prodhuesit e fonogrameve; 2. Botimet e njëkohshme; 3. E drejta për të hequr zbatimin e disa kritereve

1. Çdo vend kontraktues do t'u akordojë trajtim kombëtar prodhuesve të fonogrameve sa herë që do të përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) prodhuesi i fonogramit është shtetas i huaj; një shteti kontraktues (kriteri i kombësisë);

b) fiksimi i parë i tingullit është realizuar në një vend tjetër kontraktues (kriteri i fiksimit);

c) fonogrami është botuar për herë të parë në një vend tjetër kontraktues (kriteri i botimit).

2. Në qoftë se botimi i parë është bërë në një vend jokontraktues, por që fonogrami ka qenë botuar gjithashtu, në tridhjetë ditët në vazhdim pas botimit të parë, në një vend kontraktues (botim i

njëkohshëm), ky fonogram do të konsiderohet sikur të ishte botuar për herë të parë në vendin kontraktues.

3. Çdo vend kontraktues, me anë të një njoftimi të depozituar pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mund të deklarojë që ai nuk do të zbatojë, qoftë kriterin e botimit, qoftë kriterin e fiksimit. Ky njoftim mund të depozitohet në momentin e ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, ose në çdo moment tjetër; në këtë rast, ajo do të ketë efekt vetëm gjashtë muaj pas depozitimit të saj.

Neni 6

Përhapja e mbrojtur: 1. Kriteret e bashkimit për organizmat e radioshpërndarjes; 2. Mundësia si rezervë

1. Çdo vend kontraktues do t'u akordojë një trajtim kombëtar organizmave të radiodifuzionit sa herë që do të përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) selia sociale e organizmit të radioshpërndarjes është vendosur në një vend tjetër kontraktues;

b) emisioni është shpërndarë nga një transmetues i vendosur në territorin e një vendi tjetër kotnraktues;

c) çdo vend kontraktues, me anë të një njoftimi të depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mund të deklarojë që nuk do të akordojë mbrojtje të atyre emisioneve, vetëm në qoftë se selia sociale e organizmit të radioshpërndarjes është vendosur në një vend tjetër kontraktues dhe nëse emisioni është shpërndarë nga një transmetues i vendosur në territorin e të njëjtit vend kontraktues.

Ky njoftim mund të bëhet në momentin e ratifikimit, të pranimit ose të aderimit (anëtarësimit), ose në çdo moment tjetër; në këtë rast, ai do të bëhet i efektshëm vetëm gjashtë muaj pas depozitimit.

Neni 7

Mbrojtja minimale e artistëve interpretues ose ekzekutues: 1. Të drejta të veçanta; 2. Marrëdhëniet e artistëve me organizmat e radioshpërndarjes

1. Mbrojtja e parashikuar nga Konventa aktuale në favor të artistëve interpretues ose ekzekutues duhet të lejojë që t'i bëhet pengesë:

a) radioshpërndarjes dhe komunikimit në publik të ekzekutimit të saj pa pëlqimin e tyre, përveç rasteve kur ekzekutimi i përdorur për radioshpërndarje ose komunikim në publik është vetë tashmë një ekzekutim i përhapur ose është bërë duke u nisur nga një fiksim;

b) fiksimit pa pëlqimin e tyre mbi një mbështetje materiale të ekzekutimit të tyre të pafiksuar;

c) riprodhimit pa pëlqimin e tyre të një fiksimi të ekzekutimit të tyre:

(i) nëse edhe vetë fiksimi i parë është bërë pa pëlqimin e tyre;

(ii) nëse riprodhimi është bërë me qëllime të tjera përveç atyre për të cilat ata kanë dhënë pëlqimin e tyre;

(iii) nëse fiksimi i parë është bërë sipas dispozitave të nenit 15 dhe është riprodhuar me qëllime të tjera nga ato të parashikuara nga këto dispozita.

2. (1) I takon legjislacionit kombëtar të vendit kontraktues, në territorin e të cilit është kërkuar mbrojtja për të plotësuar mbrojtjen kundër ripërhapjes, fiksimit me qëllime radioshpërndarjeje dhe riprodhimit të një fiksimi të tillë me qëllim radiopërhapjeje, kur artisti interpretues ose ekzekutues ka pranuar radioshpërndarjen.

(2) Modalitetet e përdorimit nga organizmat e radioshpërndarjes të fiksimeve të kryera me qëllim të përhapjes radiodifuzive do të rregullohen sipas legjislacionit kombëtar të vendit kontraktues në territorin e të cilit është kërkuar mbrojtja.

(3) Sidoqoftë, legjislacioni kombëtar, në rastet e parashikuara në kryeradhët (1) dhe (2) të paragrafit aktual, nuk do të dinin të kishin efekt që të privonin artistët interpretues ose ekzekutues nga kapaciteti për të rregulluar me rrugë kontraktuese, marrëdhëniet e tyre me organizma të radiodifuzionit.

Neni 8
Ekzekutivet kolektive

Çdo vend kontraktues, me anë të legjislacionit të tij kombëtar, mund të përcaktojë modalitetet e mëposhtme, sipas të cilave, artistët interpretues ose ekzekutues do të jenë paraqitur, përsa i përket ushtrimit të të drejtave të tyre, atëherë kur shumë prej tyre marrin pjesë në të njëjtin ekzekutim.

Neni 9
Artistët e varietesë dhe të cirkut

Çdo vend kontraktues, me anë të legjislacionit të tij kombëtar, mund të shtrijë mbrojtjen e parashikuar nga Konventa aktuale edhe për artistët të cilët nuk ekzekutojnë vepra letrare ose artistike.

Neni 10
Të drejtat e riprodhimit të prodhuesve të fonogrameve

Prodhuesit e fonogrameve gëzojnë të drejtën që të autorizojnë ose të ndalojnë riprodhimin direkt ose indirekt të fonogrameve të tyre.

Neni 11
Formalitete për fonogramet

Kur një vend kontraktues kërkon, sipas legjislacionit kombëtar, plotësim të formaliteteve, si kusht të mbrojtjes, në lëndën e fonogrameve, të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve ose të artistëve interpretues ose ekzekutues, ose të të dyja palëve, këto kërkesa do të konsiderohen si të kënaqshme nëse të gjithë ekzemplarët në tregtinë e fonogramit të botuar, ose domethënia, mbajnë një vlerësim të përbërë nga simboli (P) të shoqëruar nga udhëzimi i vitit të botimit të parë, e vënë në një mënyrë që tregon në mënyrë të qartë që mbrojtja është rezervuar. Për më tepër, nëse ekzemplarët e tyre nuk lejojnë që të identifikohet prodhuesi i fonogramit ose titullari i licencës së pranuar nga prodhuesi (me anë të emrit, të markës ose të çdo përcaktimi tjetër), shënimi duhet të përmbajë gjithashtu emrin e titullarit të të drejtave të prodhuesit të fonogramit. Së fundi, nëse ekzemplarët nuk lejojnë që të identifikohen interpretuesit ose ekzekutuesit kryesorë, shënimi duhet të kuptojë gjithashtu emrin e personit që në vendin ku ka ndodhur fiksimi pra ky person ka ose mban të drejtat e këtyre artistëve.

Neni 12
Përdorimet sekondare të fonogrameve

Kur një fonogram i botuar me qëllim fitimi ose një riprodhim i këtij fonogrami, është përdorur direkt për radiodifuzion ose për një komunikim të çfarëdoshëm në publik, një shpërblim i paanshëm dhe unik do të derdhet nga përdoruesi për artistët interpretues ose ekzekutues, ose prodhuesve të fonogrameve ose që të dyve. Legjislacioni kombëtar, si pasojë e mungesës së marrëveshjeve ndërmjet këtyre të interesuarve të ndryshëm, pra mund të përcaktojë kushtet e shpërndarjes së këtij shpërblimi.

Neni 13
Mbrojtja minimale e organizmave të radioshpërndarjes

Organizmat e radioshpërndarjes gëzojnë të drejtën që të autorizojnë ose që të ndalojnë:
a) ripërhapjen e emisioneve të tyre;
b) fiksimin mbi një mbështetje materiale të emisioneve të tyre;
c) riprodhimin:
(i) fiksime, të bëra pa pëlqimin e tyre, të emisioneve të tyre;
(ii) fiksime, sipas dispozitave të nenit 15, të emisioneve të tyre dhe të riprodhuara me qëllime

të tjera nga ato të synuara nga të ashtuquajturat dispozita;

d) komunikimin në publik të emisioneve të tyre të televizionit, kur ai bëhet në vende të pranueshme në publik, me kusht që të paguhet e drejta e hyrjes; i përket legjislacionit kombëtar të vendit ku është kërkuar mbrojtja e kësaj të drejte për të përcaktuar kushtet e ushtrimit të të mbiquajturit e drejtë.

Neni 14

Zgjatja minimale e mbrojtjes

Zgjatja e mbrojtjes për t'u akorduar sipas Konventës aktuale nuk mund të jetë më e ulët se një periudhë prej njëzet vjetësh duke filluar nga:

a) fundi i vitit të fiksimit, për fonogramet dhe ekzekutimet e fiksuara mbi këto të fundit;

b) fundi i vitit kur ka ndodhur ekzekutimi, për ekzekutimet që nuk janë fiksuar mbi fonograme;

c) fundi i vitit kur ka ndodhur emision, për emisionet e radiodifuzionit.

Neni 15

Përjashtime të autorizuara: 1. Kufizime të mbrojtjes;
2. Paralelizmi me të drejtën e autorit

1. Çdo vend kontraktues ka të drejtën që të parashikojë në legjislacionin e tij kombëtar përjashtime në mbrojtjen e garantuar nga Konventa aktuale në rastet e mëposhtme:

a) kur bëhet fjalë për një përdorim privat;

b) kur ka përdorime me fragmente të shkurtra me rastin e një përmbledhjeje të një ngjarjeje nga aktualiteti;

c) kur ka një fiksim kalimtar ose të përkohshëm nga një organizëm i radioshpërndarjes me mjetet e veta për emisionet e veta;

d) kur ka një përdorim vetëm për qëllime edukative ose kërkimore e shkencore.

2. Pa prekur dispozitat e paragrafit 1 të mësipërm, çdo vend kontraktues ka të drejtën që të parashikojë në legjislacionin e tij kombëtar, përsa i përket artistëve interpretues dhe ekzekutues, prodhuesve të fonogrameve dhe organizmave të radiodifuzionit, kufizime të të njëjtës natyrë si ato që janë parashikuar në këtë legjislacion përsa i takon mbrojtjes së të drejtave të autorit mbi veprat letrare dhe artistike.

Sidoqoftë, licenca të detyrueshme mund të caktohen vetëm atëherë kur ato janë në pajtueshmëri me dispozitat e Konventës aktuale.

Neni 16

1. Duke u bërë pjesëtar i Konventës aktuale, çdo vend pranon të gjitha detyrimet dhe është i pranueshëm për të gjitha avantazhet që ajo parashikon. Sidoqoftë, një vend do të mund që të specifikojë në çdo moment me anë të një njoftimi të depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara:

a) përsa i takon nenit 12:

(i) që ai nuk do të aplikojë ose zbatojë asnjë nga dispozitat e këtij neni;

(ii) që ai nuk do të zbatojë dispozitat e këtij neni përsa i takon disa përdorimeve;

(iii) që ai nuk do të zbatojë dispozitat e këtij neni përsa i përket fonogrameve, prodhuesi i të cilave është shtetas i huaj i një vendi kontraktues;

(iv) ai do të kufizojë zgjatjen dhe vazhdimësinë e mbrojtjes së parashikuar në këtë nen, me ato të mbrojtjes që ky vend i fundit kontraktues akordon për fonogramet e fiksuara për herë të parë nga shtetasi i huaj i vendit që është autor i deklaratës; sidoqoftë, kur vendi kontraktues, prodhuesi i të cilit është një shtetas i huaj, nuk akordon mbrojtjen të njëjtit ose të njëjtëve përfitues, si dhe vendi kontraktues autor i deklaratës, ky fakt nuk do të konsiderohet sikur përbën një diferencë përsa i përket shtrirjes së mbrojtjes;

b) përsa i takon nenit 13, ai nuk do të zbatojë dispozitat e paragrafit 13.d) të këtij neni; nëse një vend kontraktues bën një deklaratë të tillë, vendet e tjera kontraktuese nuk do t'i akordojnë të drejtën e parashikuar në nenin 13.d) organizmave të radiodifuzionit që kanë selinë e tyre në territorin e këtij shteti.

2. nëse shënimi i paraqitur në paragrafin 1 të nenit aktual është depozituar në një datë të mëvonshme se ajo e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit ose aderimit, ajo do të jetë e efektshme vetëm gjashtë muaj pas depozitimit të tij.

Neni 17

Vendet që aplikojnë të vetmin kriter të fiksimit

Çdo vend legjislacioni kombëtar i të cilit është në fuqi qysh më 26 tetor 1961, u akordon prodhuesve të fonogrameve një mbrojtje të vendosur në funksion të të vetmit kriter të fiksimit, me anë të një njoftimi të depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në të njëjtën kohë me instrumentin e tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, do të mund të deklarojë që ai nuk do të zbatojë veçse kriterin e fiksimit sipas nenit 5, dhe tamam ky kriter i fiksimit në vend të kriterit të kombësisë së prodhuesit sipas paragrafëve 16.1) a (iii) dhe (iv).

Neni 18

Modifikimi ose tërheqja e rezervave

Çdo vend i cili ka bërë një nga deklaratat e parashikuara në nenin 5.3), nenin 6.2), ose në nenin 17 mundet, me anë të një notifikimi të ri drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të thjeshtojë ose pakësojë fuqinë ose ta tërheqë atë.

Neni 19

Mbrojtja e artistëve interpretues ose ekzekutues në fiksimet e figurave ose të figurës dhe zërit

Megjithë dispozitat e tjera të Konventës aktuale, neni 7 nuk do të jetë më i zbatueshëm në momentin që një artist interpretues ose ekzekutues do të ketë dhënë pëlqimin e tij përsa i takon përfshirjes së ekzekutimit të tij në një fiksim të figurës ose të figurës dhe të zërit.

Neni 20

Mosretroaktiviteti i Konventës

1. Konventa aktuale nuk cënon të drejtat e fituara në cilindo prej vendeve kontraktuese para datës së hyrjes në fuqi për këtë vend të Konventës.

2. Asnjë vend kontraktues nuk është i detyruar që të zbatojë dispozitat e Konventës aktuale për ekzekutimet ose emisionet e radioshpërndarjes që janë kryer ose për fonogramet e regjistruara para datës së hyrjes në fuqi për këtë vend (shtet) të Konventës.

Neni 21

Burime të tjera mbrojtjeje

Mbrojtja e parashikuar nga konventa aktuale nuk do të cënonte atë prej së cilës do të mund të përfitonin artistët interpretues ose ekzekutues, prodhuesit e fonogrameve dhe organizmat e radiodifuzionit.

Neni 22

Rregullime të veçanta

Vendet kontraktuese kanë të drejtë që të marrin ndërmjet tyre vendime për rregullime të veçanta, sikur këto rregullime t'u jepnin artistëve interpretues ose ekzekutues, prodhuesve të fonogrameve ose organizmave të radiodifuzionit të drejta më të gjëra, sesa ato të akorduara nga

Konventa aktuale ose ato do të mbyllnin përsëri dispozita të tjera jo të ndryshme nga këto të mësipërmet.

Neni 23
Nënshkrimi dhe depozitimi i Konventës

Konventa aktuale do të jetë depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ajo është e hapur deri më datë 30 qershor 1962, për nënshkrimin e vendeve të ftuara në Konferencën Diplomatike mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare të Artistëve Interpretues ose Ekzekutues, të Prodhuesve të Fonogrameve dhe të Organizmave të Radiodifuzionit, të cilat janë pjesë e Konventës universale mbi të drejtat e autorit ose anëtarë të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike.

Neni 24
Hyrja në Konventë

1. Konventa aktuale do t'i nënshtrohet ratifikimit ose pranimit të vendeve nënshkruese.
2. Konventa aktuale do të jetë e hapur për pranimin e vendeve të ftuara në Konferencën e përcaktuar në nenin 23, si dhe në pranimin e çdo vendi anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me kusht që vendi aderues të jetë pjesë e Konventës universale mbi të drejtat e autorit ose anëtar i Unionit ndërkombëtar për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike.
3. Ratifikimi, pranimi ose aderimi do të bëhet me anë të depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 25
Hyrja në fuqi e Konventës

1. Konventa aktuale do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit ose aderimit.

2. Si pasojë Konventa do të hyjë në fuqi për çdo vend, tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit.

Neni 26
Zbatimi i Konventës nga legjislacioni i brendshëm

1. Çdo vend kontraktues, konform me dispozitat e kushtetutës së tij, angazhohet që të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e Konventës aktuale.
2. Në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, çdo vend duhet të jetë në gjendje, konform legjislacionit kombëtar, që të zbatojë dispozitat e Konventës aktuale.

Neni 27
Zbatueshmëria e Konventës në disa territore

1. Çdo vend, në momentin e ratifikimit të pranimit ose të aderimit, ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund që të deklarojë me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjthshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që Konventa aktuale do të shtrihet në të gjithë territorin ose në një pjesë të çfarëdoshme të territorit për të cilën ai siguron marrëdhënie ndërkombëtare, me kusht që Konventa universale mbi të drejtat e autorit ose Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike të jetë e zbatueshme në territoret për të cilat bëhet fjalë. Ky njoftim do të jetë i efektshëm vetëm pas tre mujash nga data e marrjes.
2. Deklaratat e njoftimeve për të cilat është folur në nenin 5.3), nenin 6.2), nenin 16.1), nenin 17 ose nenin 18, mund që të shtrihen në të gjithë territorin ose në një territor të çfarëdoshëm siç u

përcaktua në paragrafin e mëparshëm.

Neni 28
Pushimi i efekteve të konventës

1. Çdo vend kontraktues do të ketë mundësinë që të denoncojë Konventën aktuale, ose në emër të tij personal, ose në emër të një territori të çfarëdoshëm nga bashkësia e territoreve të përcaktuara në nenin 27.

2. Denoncimi do të bëhet me anë të një note drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe bëhet i efektshëm dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën është marrë ky njoftim.

3. Mundësia e denoncimit të parashikuar në nenin në fjalë nuk mund të ushtrohet nga vendi kontraktues përpara mbarimit të një periudhe prej pesë vjetësh duke filluar nga data e nisjes të të cilës, Konventa ka hyrë në fuqi kundrejt të të ashtuquajturit vend.

4. Çdo vend kontraktues pushon së qeni pjesë e Konventës aktuale që në momentin kur ai nuk do të jetë më as pjesë e Konventës universale mbi të drejtën e autorit, as anëtar i Unionit ndërkombëtar për Mrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike.

5. Konventa aktuale pushon së qeni e zbatueshme në të gjithë territorin siç parashikon neni 27, që në momentin kur as Konventa universale mbi të Drejtën e Autorit dhe as Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike nuk do të zbatohen më në këtë territor.

Neni 29
Përmbledhje e Konventës

1. Pasi Konventa aktuale ka qenë në fuqi gjatë pesë vjetëve, çdo vend kontraktues, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, do të mund që të kërkojë një thirrje ose mbledhje të një konference që ka për qëllim që të përmbledhë Konventën. Sekretari i Përgjithshëm ia bën të njohur këtë kërkesë të gjithë vendeve kontraktuese, nëse në një afat kohor prej gjashtë muajsh duke filluar nga data kur njoftimi është bërë tek Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të bashkuara, të paktën gjysma e vendeve kontraktuese i japin miratimin për këtë kërkesë. Sekretari i Përgjithshëm informon për këtë Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën dhe Drejtorin e Zyrës së Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, që do të thërrasin një konferencë përmbledhëse në bashkëpunim me Komitetin ndërqeveritar të parashikuar në nenin 32.

2. Çdo përmbledhje e Konventës aktuale duhet të adoptohet për pjesën më të madhe që përfshin dy të tretat e vendeve që janë prezent në Konferencën përfundimtare me kusht që kjo pjesë më e madhe të përfshijë dy të tretat e vendeve që, në datën e Konferencës përmbledhëse, janë pjesë e Konventës.

3. Në rast kur do të adoptohet një Konventë e re që bën një përsëritje totale ose të pjesshme të Konventës aktuale, në qoftë se Konventa aktuale nuk disponon ndryshe:

a) Konventa aktuale do të pushojë së qeni e hapur për ratifikimin, pranimin ose aderimin duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Konventës së re përmbledhëse;

b) Konventa aktuale do të mbetet në fuqi përsa i takon raporteve me vendet kontraktuese të cilat nuk do të bëhen pjesë e Konventës së re.

Neni 30
Rregullimi i mosmarrëveshjeve ndërmjet vendeve kontraktuese

Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë vendeve kontraktuese përsa i takon interpretimit ose zbatimit të Konventës aktuale, e cila nuk do të jetë rregulluar me anë të negociatave, me kërkesën e njërës nga palët në mosmarrëveshje, do të jetë dërguar përpara Oborrit Ndërkombëtar të Drejtësisë me qëllim që ai të marrë një vendim nga ky i fundit, në qoftë se vendet në fjalë nuk bien dakord për

një mënyrë tjetër rregullimi.

Neni 31
Kufizimet e mundësisë për të bërë rezerva

Pa hequr dorë ng dispozitat e nenit 5.3), të nenit 6.2), të nenit 16.1) dhe të nenit 17, nuk pranohet asnjë rezervë për Konventën aktuale.

Neni 32
Komiteti ndërqeveritar

1. Ngrihet një Komitet ndërqeveritar i cili ka për mision:

a) që të shqyrtojë problemet që lidhen me zbatimin dhe me funksionimin e Konventës aktuale;

b) të mbledhë propozimet dhe të përgatisë dokumentacionin përkatës për përmbledhje të mundshme të Konventës.

2. Komiteti do të përbëhet nga përfaqësues nga vendet kontraktuese, të zgjedhur duke marrë në konsideratë një ndarje gjeografike. Numri i anëtarëve të komitetit do të jetë gjashtë nëse ai i vendeve kontraktuese është më i vogël ose i barabartë me dymbëdhjetë, dhe nëntë, nëse ai i vendeve kontraktuese është nga trembëdhjetë në tetëmbëdhjetë, dhe dymbëdhjetë, nëse numri i vendeve kontraktuese e kalon numrin tetëmbëdhjetë.

3. Komiteti do të përbëhet dymbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të Konventës, në vazhdim të një votimi të organizuar ndërmjet vendeve kontraktuese të cilat disponojnë secili një votë nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtre të Punës, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, dhe Drejtori i Zyrës së Unionit Ndërkombëtar për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, konform rregullave që do të mirtohen paraprakisht nga shumica absolute e vendeve kontraktuese.

4. Komiteti do të zgjedhë presidentin e tij të zyrës. Ai do të vendosë një rregullore të brendshme kryesisht mbi funksionimin e tij në të ardhmen dhe mbi mënyrën e tij të rinovimit; kjo rregullore duhet të sigurojë rrotacionin ndërmjet vendeve të ndryshme konktraktuese.

5. Sekretariati i Komitetit do të përbëhet nga funksionarë të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, dhe Zyra e Unionit ndërkombëtar për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike të zgjedhura respektivisht nga drejtorët e përgjithshëm dhe nga drejtori i tre institucioneve të interesuara.

6. Mbledhjet e Komitetit, i cili do të mbahet sa herë që shumica e anëtarëve të tij do ta gjykojë të arsyeshme, do të kryhen përkatësisht në selitë respektive të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën dhe të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike.

7. Shpenzimet e anëtarëve të Komitetit do të jenë në ngarkim të qeverive të tyre përkatëse.

Neni 33
Gjuhët e Konventës

1. Konventa aktuale është në frëngjisht, anglisht dhe në spanjisht, siç e dëshmojnë dhe këto tre tekste.

2. Nga ana tjetër, do të vendoset për tekste zyrtare të Konventës aktuale në gjermanisht, italisht dhe portugalisht.

Neni 34
Njoftime

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do të informojë vendet e ftuara në Konferencën e përcaktuar në nenin 23 dhe çdo vend anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, dhe Drejtorin e Zyrës

së Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike:

a) për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit ose të aderimit;

b) për datën e hyrjes në fuqi të Konventës;

c) për njoftimet, deklaratat dhe çdo komunikim tjetër të parashikuar në Konventën aktuale;

d) për çdo rast ku do të krijohej njëra nga situatat e përcaktuara në paragrafët 28.4) dhe 28.5).

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkaura do të informojë gjithashtu Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën dhe Drejtorin e Zyrës së Unionit ndërkombëtar për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike për pyetjet dhe kërkesat që do t'u dërgohen, sipas nenit 29, si dhe për çdo komunikim të marrë nga vendet kontraktuese lidhur me temën e përmbledhjes ose revizionit të Konventës aktuale.

LIGJ
Nr.8580, datë 17.2.2000

PËR PARTITË POLITIKE

Në mbështetje të neneve 9, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Neni 2

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet:

a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike;

b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike;

c) pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.

Neni 3

Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.

Neni 4

Partitë politike, në veprimtarinë për arritjen e qëllimeve të tyre, përdorin vetëm mjete dhe

metoda demokratike.

Neni 5

Veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit.

Neni 6

Partive politike u ndalohet të krijojnë organizata me karakter ushtarak ose paraushtarak.

Neni 7

Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur:

a) organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur;

b) në dokumentet e themelimit të partisë përmendet shprehimisht ose, nga përmbajtja e tyre, del se ato janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që ndalojnë krijimin e partive ose strukturave partiake në fushat e institucionet e parashikuara prej tyre;

c) partia është krijuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) në dokumentet e themelimit të saj shprehet qëllimi për përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore;

d) në dokumentet e themelimit të saj shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, krahinore ose etnike;

dh) mbështetet në metoda totalitariste, si dhe ka karakter të fshehtë;

e) me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.

Neni 8

Veprimtaria antikushtetuese e partive politike është e ndaluar.

Konstatimi i veprimtarisë antikushtetuese të partisë politike dhe ndalimi i saj vendoset nga Gjykata Kushtetuese.

KREU II
KRIJIMI I PARTIVE POLITIKE

Neni 9

Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent.

Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.

Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos,thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.

Neni 10

Pasi mbledhja e anëtarëve themelues të partisë politike të ketë miratuar dokumentet e partisë, programin, statutin, si dhe organet drejtuese të saj, duhet të paraqitet në gjykatë kërkesa për regjistrimin e saj.

Kërkesa për regjistrimin e një partie politike duhet të nënshkruhet nga jo më pak se 500 shtetas shqiptarë, anëtarë themelues të saj, me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Në dokumentet për regjistrimin e partisë politike, përcaktohen:

a) emërtimi dhe selia e partisë;

b) qëllimet dhe detyrat e saj;

c) organet udhëheqëse dhe ndërtimi i partisë;

ç) burimet e financimit.

Neni 12

Emri i një partie duhet të jetë i dallueshëm qartë nga ai i partive të tjera ekzistuese. Inicialet dhe emblemat e partive politike nuk duhet të përputhen.

Në zgjedhje përdoren vetëm emrat ose inicialet e partive politike që janë të regjistruara.

Neni 13

Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji.

Në rastin kur dokumentet e partive politike nuk janë të rregullta, gjykata, brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për të bërë plotësimet përkatëse.

Neni 14

Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme.

Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve.

Neni 15

Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës.

KREU III
MJETET FINANCIARE DHE MATERIALE TË PARTIVE

Neni 16

Partitë politike janë person juridik. Ato kanë pasuri për kryerjen e veprimtarisë së tyre. Partitë politike kanë mjetet e tyre të propagandës, si dhe instituiconet përkatëse realizuese të tyre.

Neni 17

Burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga:

a) kuotat e anëtarësisë;

b) çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme;

c) ndihma financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit, të miratuar me ligj nga

Kuvendi.

Neni 18

Shteti ndihmon materialisht partitë politike në kohën e krijimit të tyre. Ndihma jepet menjëherë pas regjistrimit dhe është 100 000 lekë.

Neni 19

Në buxhetin shtetëror vjetor parashikohet ndihma financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

70 për qind e ndihmës shetërore ndahet në pjesë të barabarta sipas votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, pa kufi të poshtëm, çka nënkupton që çdo parti merr një mbështetje financiare për votat që ka fituar. Kjo nuk kërkon domosdoshmërisht të ketë deputet në Kuvend;

20 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë grup parlamentar;

10 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare me lista kombëtare.

Neni 20

Ndalohet krijimi i personave juridikë tregtarë e jotregtarë, që ushtrojnë veprimtari me qëllim fitimi, nga partitë politike apo nëpërmjet të tretëve.

Partitë politike mund t'i përdorin pasuritë e mjediset e tyre për veprimtari ekonomiko-shoqërore të karakterit të botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve apo dhënies me qera, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21

Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror.

Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas.

Neni 22

Shteti lehtëson veprimtarinë e partive politike. Lehtësimi nga shteti i veprimtarisë së partive politike përfshin fushat si vijon:

a) Partitë kanë të drejtë të përdorin pa shpërblim mjetet e informimit masiv publik në rast fushatash elektorale dhe referendumesh.

b) Partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore. Kur kjo është e pamundur, shteti merr përsipër pagesën e qirasë.

Neni 23

Kontrolli i Lartë i Shtetit është organi kompetent i ngarkuar me funksionin e kontrollit financiar mbi partitë. Ky kontroll nuk do të kufizohet vetëm në pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike, por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë të ushtrojë kontroll financiar mbi partitë politike para dhe pas fushatave elektorale.

Neni 24

Në rastet kur një parti politike nuk paguan detyrimet ndaj shtetit si gjoba, gjyqe të humbura, fatura konsumi etj., atëherë shuma përkatëse i mbahet nga buxheti shtetëror vjetor, që parashikohet për ndihmë financiare të partisë përkatëse.

KREU IV
NDARJA E PARTIVE POLITIKE

Neni 25

Në rastin e ndarjes së partisë politike me marrëveshje, ndërmjet palëve vendoset për përkatësinë e emrit, të simbolit, të flamurit të partisë dhe të pasurisë.

Kur nuk ka marrëveshje midis palëve, kjo bëhet me vendim gjykate.

KREU V
SHPËRNDARJA E PARTIVE POLITIKE

Neni 26

Partia politike shpërndahet:

a) kur shkrihet ose bashkohet me parti të tjera;

b) kur ndahet në dy ose më shumë parti të tjera me emër të ri;

c) kur vetëshpërndahet në përputhje me normat e statutit të saj;

ç) kur numri i anëtarëve të partisë ka mbërritur nën numrin minimal të caktuar me statut ose sipas këtij ligji;

d) kur ndalohet veprimtaria e saj me vendim të organit kompetent.

Vendimi për shpërndarjen e partisë politike depozitohet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës. Kjo gjykatë vendos çregjistrimin e partisë dhe procedurat përkatëse për likuidimin e saj.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë i kalon gjykatës së shkallës së parë të Rrethit të Tiranës, dokumentet e partive politike të regjistruara prej saj deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjykata e shkallës së parë të Rrethit të Tiranës bën kalimin në regjistrin e saj të veçantë për partitë politike brenda 90 ditëve nga marrja në disponim e dokumentacionit.

Neni 28

Ligji nr.7502, datë 25.7.1991 “Për partitë politike” dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2566, datë 28.2.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr.8581, datë 17.2.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET 8508, DATË 7.7.1999; NR.8519, DATË 30.7.1999 DHE NR.8552, DATË 18.11.1999

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet 8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999 dhe nr.8552, datë 18.11.1999 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje:
"23. Taksë e shitjes së pasurisë së luajtshme (automjetet)."

Neni 2

Në nenin 6, në pikën I "Taksat kombëtare" pas shkronjës "rr" shtohet shkronja "s" me këtë përmbajtje:
"s. Taksa e shitjes së pasurisë së luajtshme (automjetet) është në masën 2 për qind të vlerës së shitjes të pasurisë. Kjo taksë paguhet në çastin e kryerjes së aktit të shitjes.
Kjo taksë do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2001."

Neni 3

Në neni 8, në shkronjën "A. Për taksat kombëtare", pikat 3 dhe 17 ndryshojnë, përkatësisht, si vijon:

"3. Për taksën vjetore të tonazhit të automjeteve për aks e cila ndahet:	10 për qind
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	8 për qind
- Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik	2 për qind"
"17. Për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve e cila ndahet:	10 për qind
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	8 për qind
- Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik	2 për qind"

Neni 4

Në nenin 9, në pikën "A. Për taksat kombëtare", pas shkronjës "p" shtohet shkronja "q", ndërsa shkronjat "c", "ç" dhe "e" ndryshohen si vijon:
"q. Për taksën për shitjen e pasurisë së luajtshme ngarkohen zyrat e noterisë në çastin që kryhet akti i shitjes."
"c. Për taksën vjetore të tonazhit të automjeteve për aks ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor."

“ç. Për vjeljen e taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të ardhurat nga kjo taksë përdoren, kryesisht, për përmirësimin e sistemit të sinjalizimit rrugor.

Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik ndërmjet degëve të qarkullimit rrugor në rrethe bën kontrollin e vjeljes së taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe të taksës së tonazhit për aks.”

“e. Për taksën për pajisje me dëshmi aftësie për drejtim automjeti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”

Neni 5

Në lidhjen nr.2 “Taksat për shërbimet konsullore”, në pikën I “Taksat për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit”, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Turistët individualë ditorë, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje në masën 10 USD.

Nuk i nënshtrohen pagimit të kësaj takse të gjithë turistët ditorë, të organizuar në grupe.”

Neni 6

Lidhjet nr.3 dhe nr.5 ndryshojnë sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2567, datë 28.2.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIDHJA NR.3
TAKSAT VJETORE TË TONAZHIT TË AUTOMJETEVE PËR AKS

Nr.Tipi i mjetit	Masa e taksës për një aks (Lekë)
1. Mikrobuz (më i vogël ose i barabartë 8+1)	5 000
2. Furgon dhe kamion deri në 3.5 tonë	10 000
3. Kamion mbi 3.5 deri në 7.5 tonë	15 000
4. Kamion mbi 7.5 deri 17 tonë	18 000
5. Kamion mbi 17 tonë	23 000
6. Autobuz më i vogël ose i barabartë 32 +1 vende	10 000
7. Autobuz më i vogël ose i barabartë 42 + 1 vende	13 000
8. Autobuz më i madh mbi 42+1 vende	15 000
9. Rimorkio deri në 7 tonë	7 500
10. Rimorkio mbi 7 tonë	10 000

Mjetet e klasifikuara (sipas Kodit Rrugor) si makina transporti (autovinça, autobetoniera, vetëngarkuesit etj.) do të paguajnë një taksë sa dyfishi i taksës së tonazhit të automjeteve analoge me to.

Taksat e mësipërme janë vetëm për një aks. Pagesa e plotë e taksës do të jetë taksa për një aks shumëzuar me numrin e akseve.

LIDHJA NR.5
TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË AUTOMJETEVE

Tipi i mjetit	Masa e taksës (Lekë)
1. Motomjete	600
2. Autoveturë	2 400
3. Mikrobuz (më i vogël ose i barabartë 8 +1 vende)	4 800
4. Furgon dhe kamion deri në 3.5 tonë	3 600
5. Kamion mbi 3.6 deri në 7.5 tonë	4 800
6. Kamion mbi 7.6 deri 17 tonë	6 000
7. Kamion mbi 17	8 000
8. Autobuz (më i vogël ose i barabartë 32 +1 vende)	6 000
9. Autobuz (më i vogël ose i barabartë 42 +1 vende)	7 200
10.Autobuz më i madh 42 +1 vende	8 400
11. Autobuz artikular më i madh se 42 vende	9 000
12. Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec) më të vegjël se 7.5 tonë	3 000
13. Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor me goma, fadromë, autovinç, vinç me goma) mbi 7.5 tonë	3 600

LIGJ
Nr. 8582, datë 23.2.2000

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8306, DATË 14.3.1998 "PËR STRATEGJINË E PRIVATIZIMIT TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë ndërmarrjet, shoqëritë tregtare ose pjesë të tyre, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe kanë rezultat financiar me humbje për mbi 3 vjet rresht. Këto raste përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2568, datë 1.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8583, datë 1.3.2000

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8388, DATË 5.8.1998 "PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE DHE TË MUNICIONEVE LUFTARAKE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8388, datë 5.8.1998 "Për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake" në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe një shtesë:

- Në rreshtin e dytë fjalët "Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministri i Pushtetit Lokal" zëvendësohen me fjalën "Zëvendëskryeministri".
- Pas fjalëve "Ministri i Mbrojtjes – anëtar", shtohet një rresht me këtë përmbajtje:
"Ministri i Pushtetit Vendor – anëtar."
- Hiqet rreshti i fundit me këtë përmbajtje "Drejtor i Përgjithshëm i Pushtetit Lokal – anëtar."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2571, datë 13.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8589, datë 20.3.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E EMERGJENCËS PËR RIPARIMIN E RRUGËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e emergjencës për riparimin e rrugëve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2580, datë 27.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

NUMRI I KREDISË 3303 ALB

MARRËVESHJA E KREDISË SË ZHVILLIMIT

MARRËVESHJE E DATËS 16 DHJETOR 1999 MIDIS SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (SHOQATA)

Ndërsa, (A) pasi Huamarrësi të jetë i kënaqur me fizibilitetin dhe prioritetin e Projektit të përshkruar në Skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje, i ka kërkuar Shoqatës ta ndihmojë në financimin e këtij Projekti; dhe

Ndërsa, Shoqata ka rënë dakord midis të tjerash për sa më sipër, për t'ia dhënë këtë Kredi Huamarrësit mbi bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Në bazë të sa më sipër, palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni I
Kushtet e Përgjithshme
Përcaktimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës të datës 1 janar, 1985 (me modifikimet e bëra gjatë 2 dhjetorit të vitit 1997) (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

Seksioni 1.02. Me përjashtim të rasteve kur nga konteksti kërkohet ndryshe, termat e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Preambulin e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara. Termat shtesë që vijojnë kanë këto kuptime:

(a) "EMP" ka kuptimin plani për menaxhimin e ambientit për projektin, i pranueshëm për IDA-n, i përshtatur nga Huamarrësi në 15.11.1999, që siguron dispozitat për ndikime të mundshme mjedisore dhe masat e propozuara lehtësuese (të përfshira në PIP);

(b) "PIP" do të thotë Plani për Zbatimin e Projektit të datës …..1999, që siguron midis të tjerave, EMP-në, procedurat e zbatimit, politikat financiare dhe ato të kontabilitetit për sistemin e kontabilitetit dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe marrëveshjet për revizionimin, si p.sh që PIP-i mund të modifikohet hera-herës me mirëkuptimin e Huamarrësit dhe Shoqatës;

(c) "PIU" do të thotë Njësia e Zbatimit të Projektit e ngritur nga Huamarrësi në përputhje me dispozitat e Seksionit 5.01 (a) të kësaj Marrëveshjeje për qëllime të menaxhimit të projektit;

(d) "Llogaria e Projektit" do të thotë llogaria të cilës i referohet Seksioni 5.01 (b) i kësaj Marrëveshjeje, që mbahet nga Huamarrësi në monedhën vendëse dhe që do të përdoret për të financuar kontributet e Huamarrësit në shpenzimet e projektit; dhe

(e) "Llogaria speciale" do të thotë llogaria së cilës i referohet Seksioni 2.02 (b) i kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i huajë Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabarta me nëntë milionë e nëntëqind mijë të Drejta Speciale Tërheqjeje (SDR 9,900,000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzime të bëra (ose në rast se Shoqata bie dakord për bërjen e këtyre shpenzimeve) në lidhje me kosto të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga procedurat e Kredisë.

(b) Huamarrësi, për qëllime të Projektit, mund të hapë dhe të mbajë një llogari speciale depozituese në dollarë mbi bazën e termave dhe kushteve të kënaqshme për Shoqatën, duke përfshirë mbrojtje nga ekstradimet e llojeve te ndryshme. Depozitimet në Llogarinë Speciale dhe pagesat e bëra nga kjo Llogari do të bëhen në përputhje me dispozitat e Skedulit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e Mbylljes do të jetë 30 dhjetor 2002 apo ndonjë datë e mëvonshme siç do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata me datë 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysëm për qind (1/2 e 1%) për vit.

(b) Shuma e detyruar do të rritet: (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen, ose anullohen shumat nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 qershor menjëherë përpara datës së interesit dhe me shuma të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet: (i) në vende të tilla të kërkuara nga Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji te vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera te përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtat e një përqind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principiale të Kredisë së tërhequr dhe te papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06. Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjysëm viti më 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafëve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principiale të Kredisë me këste gjysëm vjetore të pagueshme në çdo 1 shkurt dhe 1 gusht duke filluar nga 1 shkurti 2010 dhe duke përfunduar në 1 gusht 2039. Çdo këst duke përfshirë këstin e pagueshëm në 1 për qind do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principiale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) i kësaj shume principiale.

(b) Kur (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga Shoqata; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë së Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) ku i kërkohet Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principiale e Kreditit; dhe

(B) ku i kërkohet Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principiale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysëm vjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje prej një minimumi pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principialit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën e

interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principiale të Kredisë të tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni III
Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave te Projektit të përcaktuara në Skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim do të zbatojë projektin përmes PIU-t me "due diligence" dhe efikasitet, si edhe në përputhje me praktikat e përshtatshme administrative, inxhinierike, ambjentaliste, financiare dhe ato të transportit, si edhe do të sigurojë menjëherë sipas nevojës fondet, lehtësitë, shërbimet dhe burime të tjera që kërkohen për Projektin.

(b) Pa u kufizuar ne dispozitat e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe përveç atyre rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord për ndryshe, Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit të përcaktuar në Skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të atyre rasteve për të cilat Shoqata bie dakord për ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve që kërkohen për financimin e Projektit dhe që do të financohen nga procedurat e Kredisë, do të udhëhiqet nga dispozitat e Skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e Seksionit 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa u kufizuar, Humarrësi:

a. mbi bazën e udhëzimeve të pranueshme nga IDA, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas Datës së Mbylljes apo të një date tjetër të mëvonshme për të cilën mund të bihet dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës, një plan për operacione të mëvonshme të Projektit; dhe

b. t'i japë Shoqatës një mundësi të pranueshme për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për planin në fjalë.

Neni IV
Konventat financiare

Seksioni 4.01. Huamarrësi do ta bëjë PIU-n të krijojë dhe ruajë një sistem të menaxhimit financiar, duke përfshirë regjistrimet dhe llogaritë, si edhe të përgatisë deklaratat financiare në format të pëlqyeshëm për Shoqatën, të përshtatshme për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

b. Huamarrësi do ta bëjë PIU-n:

(i) të ketë regjistrimet, llogaritë dhe deklaratat financiare të referuara në paragrafin (a) më sipër të këtij Seksioni, si edhe regjistrimet dhe llogaritë për Llogarinë Speciale për çdo vit fiskal te audituar në përputhje me standardet e auditimit të pranueshme për IDA-n, nga revizionere të pavarur të pranueshëm për Shoqatën.

(ii) t'i dorëzojë Shoqatës, sapo të jenë në dispozicion, por sidoqoftë jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të secilit prej këtyre viteve (A), një kopje të verifikuar të deklaratave financiare të referuara në paragrafin (a) të këtij Seksioni për çdo vit të audituar dhe (B) një mendim për këto deklarata, regjistrime dhe llogari dhe raportin e këtyre auditimeve nga autorët e caktuar dhe me natyrë dhe detaje të tilla që do të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata; dhe

(iii) t'i dorëzojë Shoqatës informacion shtesë në lidhje me regjistrimet dhe llogaritë dhe auditimin e tyre, si edhe në lidhje me autorët e tyre siç mundet të kërkohen hera-herës brenda arsyes nga Shoqata.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë mbi bazë të deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi:

(i) do të mbajë vetë ose do të bëjë të mbahen në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, regjistra dhe llogari të veçanta ku të reflektohen këto shpenzime;

(ii) do të ruajë deri së paku një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e auditimit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjithë regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat, dhe dokumente të tjera) që të vërtetojnë shpenzimet;

(iii) t'u bëjë të mundur përfaqësuesve të Shoqatës t'i kontrollojnë këto regjistra; dhe

(iv) të sigurohet që këto regjistra dhe llogari të përfshihen në auditimin vjetor të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni, si edhe që raporti i këtij auditimi të përmbajë një opinion të veçantë nga autorët e tij nëse deklaratat për shpenzimet e dorëzuara gjatë atij viti fiskal, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme të përfshira në përgatitjen e tyre të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet për të cilat bëhet fjalë.

Seksioni 4.02. (a). Pa u kufizuar nga dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të zbatojë një plan veprimesh me data të caktuara që të jetë i pranueshëm për Shoqatën. Qëllimi i këtij plani do të jetë të forcojë sistemin e menaxhimit financiar të cilit i referohet në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 në mënyrë që Huamarrësi të jetë në gjendje që jo më vonë se 31 Maj 2000.apo një datë tjetër për të cilën bie dakord Shoqata, të përgatisë raporte menaxhimi tri mujore, të pranueshme për Shoqatën, ku secili do të:

(i) A) përcaktohen burimet aktuale dhe aplikimi i fondeve për Projektin, në mënyrë kumulative dhe për periudhën që mbulohet nga raporti në fjalë, si edhe burimet e parashikuara dhe aplikimi i fondeve për Projektin për periudhën gjashtë mujore pas periudhës së mbuluar në raportin në fjalë, dhe (B) do të tregohen në veçanti shpenzimet e financuara nga procedurat e Kredisë gjatë periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga procedurat e Kredisë gjatë periudhës gjashtë mujore, pas periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë;

(ii) A) përshkruan progresin fizik në zbatimin e Projektit, si në mënyrë kumulative ashtu edhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, dhe (B) shpjegon ndryshimet midis synimeve aktuale dhe atyre te parashikuara më parë përsa i përket zbatimit të projektit; dhe

(iii) përcaktoj statusin e prokurimeve në bazë të Projektit dhe shpenzimet sipas kontratave të financuara nga procedurat e Kredisë në fund të periudhës që mbulohet nga Projekti në fjalë.

(b) Me përfundimin e planit të veprimeve të cilit i referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni, Huamarrësi do të përgatisë, në përputhje me udhëzimet e aplikueshme për Shoqatën dhe do t'i dërgojë Shoqatës jo më vonë se pas 45 ditëve pas fundit të çdo tre mujori kalendarik një Raport mbi Menaxhimin e Projektit për periudhën në fjalë.

Neni V
Data efektive
Përfundimi

Seksioni 5.01. Çështjet e mëposhtme specifikohen si kushte shtesë për efektivitetin e Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit brenda kuptimit të Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme:

(a) PIU është ngritur dhe funksionon me burime, staf dhe terma reference të kënaqshme për Shoqatën;

(b) Huamarrësi ka hapur një Llogari për Projektin për qëllimet e zbatimit të Projektit me një depozitë fillestare të barabartë me 50.000 dollarë; dhe

(c) Huamarrësi ka krijuar një sistem të menaxhimit financiar i cili është i kënaqshëm për Shoqatën.

Seksioni 5.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar më poshtë për qëllimet e Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni VI
Përfaqësuesi i Huamarrësit
Adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 11.03. të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Adresa ..... Teleks:
4295 Komplan AB

Për Shoqatën:

International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa..... Teleks:
INDEVAS 248423 (MCI) or
Washington, D.C. 64145 (MCI)

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, palët e më sipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë përpiluar këtë Marrëveshje që të firmoset në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më poshtë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga Petrit Bushati
Përfaqësuesi i Autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit

Nga Christiaan Poortman

DEKRET
Nr. 2524, datë 17.1.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 05. 08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Aleko Sotir Xhillari
2. Kaliopi Thoma Xhillari
3. Entela Aleko Jeguschke (Xhillari)
4. Henry Astrit Koliqi
5. Vera Abdulla Haliti (Xhafa)
6. Luiza Pjetër Plaku (Wagner)
7. Evis Ramadan Bega (Hofverberg)
8. Marin Preng Hilgenberg (Lleshi)
9. Bexhet Nasuf Mërruko
10. Julia Bexhet Mërruko
11. Angela Bexhet Mërruko
12. Petrit Gjon Biga
13. Prendush Nikë Murrizaj
14. Petrit Hetem Halili
15. Ermir Jashar Sade
16. Alketi Teodori Mato
17. Ermira Nysret Knoch (Qesku)
18. Zenepe Neshat Hummel – Dollani
19. Viktor Maliq Koltraka
20. Vjollca Sheme Koltraka (Deda)
21. Arben Jani Dako
22. Skënder Nevruz Iljazi
23. Shkurte Ramadan Iljazi
24. Xhuljana Skënder Iljazi
25. Endrit Skënder Iljazi
26. Graciana Skënder Iljazi
27. Drita Xhevdet Kama
28. Iraida Kujtim Kama
29. Agim Muharrem Llabani
30. Rogers Olsmir Agim Llabani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI
Rexhep Meidani

VENDIM
Nr. 51, datë 17.2.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.248, DATË 25.3.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT DHE KATEGORISË SË TELEFONAVE CELULARË, NË PËRDORIM TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.248, datë 25.3.1996, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në tabelën "Numri i telefonave celularë për institucionet buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen këto ndryshime:

a) Në nr.2, në institucionin "Këshilli i Ministrave", fjalët "ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik" shfuqizohen.

b) Pas nr.2, shtohet nr.2/1, me fjalët "Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë,

- Ministri……..1
- Zëvëndësministri…….1.".

2. Në pikën 3, pas fjalëve "Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit", shtohen fjalët "Zëvendëskryetarët e Kuvendit".

3. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"Për të gjithë funksionarët, të cilët gëzojnë të drejtën për t'u pajisur me telefon celular të përhershëm, me përjashtim të atyre të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe të sekretarëve të përgjithshëm në Presidencë, Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, kufiri i shpenzimeve për këtë lloj shërbimi të mos e kalojë shumën 15 mijë lekë në muaj.

Shpenzimet e tjera mbi këtë shumë përballohen nga përdoruesit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 61, datë 24.2.2000

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT DHE TË PËRGATITJES PËR PRIVATIZIM TË SHOQËRISË ANONIME "INSTITUTI I SIGURIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 12 dhe 14, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të ristrukturimit dhe të përgatitjes për privatizim të shoqërisë anonime "Instituti i Sigurimeve", që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim fillimin e procedurave ligjore të privatizimit të kësaj shoqërie në vitin 2001.

2. Ngarkohet ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PROGRAMI I RISTRUKTURIMIT DHE PËRGATITJES PËR PRIVATIZIM
TË SHOQËRISË ANONIME "INSTITUTI I SIGURIMEVE"

Programi i ristrukturimit dhe privatizimittë INSIG sh.a. parashikon një sërë masash dhe veprimesh, të ndarë në dy faza:

Faza e parë:

Ristrukturimi tekniko-administrativ dhe ekonomiko-financiar nga degët deri në zyrat qendrore.

Kjo fazë është e ndarë në dy etapa dhe do të përfshijë:

Etapën e parë:

a. Shitjen e të gjitha llojeve të produkteve të sigurimit nëpërmjet agjensive të sigurimit me të cilat janë lidhur dhe do të lidhen kontrata eskluzive agjensie, pa hequr dorë nga shitja në degët tona të sigurimeve.

b. Shndërrimin brenda 3- mujorit të parë të vitit 2000 të pikave të shitjes në disa degë kryesore si Tirana e ndonjë tjeter në agjentë me shpërblim në bazë komisioni.

c. Kalimin e disa degëve të vogla, të cilat janë jo efektive (pasi dalin me humbje) dhe kanë aktivitet të vogël e shpenzime të mëdha, në agjensi sigurimesh brenda 3-mujorit të parë të vitit 2000.

d. Degët e sigurimeve që janë efektive, nuk do të kenë më si funksion kryesor vetëm shitjen direkte të produkteve. Një pjesë e punonjësve do të kalojnë në agjentë eskluzivë të INSIG-ut. Fillimisht, atyre, për një periudhë kohe (3 deri në 6 muaj) do t'u krijohen kushte lehtësuese si: ambiente pune (zyra dhe pajisje), fillimisht pa pagesë dhe pas 6 muajve kundrejt pagimit të një qeraje, si edhe një pagë e garantuar në masën jo më pak se 50% gjatë kësaj periudhe 6 mujore.

Etapa e dytë:

Gjatë kësaj etape do të merren masa që mbajnë parasysh riorganizimin dhe ristrukturimin e INSIG sh.a. për t'ju përgjigjur sa më mirë kushteve të reja të tregut të sigurimeve dhe pa i lejuar vetes kufizimin apo humbjen e tregut të sigurimeve , siç janë :

Krijimi i nje strukture shumë më të manovrueshme dhe të shpejtë në vendimarrje në zyrat qendrore te INSIG–ut në bazë të një studimi të përgatitur mirë dhe të diskutuar gjerësisht me Drejtorët e Drejtorive dhe Këshillin Drejtues , me synim thjeshtësimin e strukturës dhe rritjen e efektivitetit të INSIG sh.a. në kushtet e reja të tregut .

Ky ristrukturim duhet të përfundojë brenda 6- mujorit të parë të vitit 2000.

Këto masa janë bërë të domosdoshme mbasi në raport me vëllimin e biznesit numri i punonjësve ne zyrat qendrore është i lartë, çka vështirëson deri në pamundësi koordinimin midis drejtorive dhe sektorëve duke krijuar shpesh dublime të panevojshme Gjithashtu numri i madh i hallkave krijon shpesh konfuzion në marrëdhëniet me degët e sigurimeve dhe klientat e mëdhenj e të mësëm qe kanë nevojë për sigurime komplekse.

Ristrukturimi në zyrat qendrore do të realizohet me kritere të shëndosha tekniko-organizative nëpërmjet bashkimeve funksionale të disa drejtorive, shkrirjes së disa të tjerave, transformimit të disa prej tyre nga drejtori në zyra ose byro, duke shmangur në cdo rast bashkimet thjesht mekanike, por duke iu permbajtur përafërsisë teknologjike.

Ky proces pritet të sjellë një reduktim të numrit aktual të punonjësve në zyrat qendrore por pa krijuar brenda mundësive shqetësime sociale akute.

Natyrisht, organigrama dhe organika mbasi të diskutohen në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Këshillin Mbikqyrës do t'i paraqiten për miratim Ministrit të Financave , si aksioneri kryesor dhe i vetëm i INSIG sh.a.

Për sa i përket punonjësve që do të reduktohen nga ristrukturimi i kompanisë në zyrat

qendrore ka dy alternativa për të zgjidhur anën sociale të problemit:

- atyre mund t'u ofrohet një kontratë agjensie për të shitur produktet e INSIG-ut , duke i dhënë për një periudhë kohe 6- mujore një shpërblim fiks në masën 50% të pagës,
- atyre që nuk do të pranonin zgjidhjen e mësipërme do t'u jepet paga e plotë për një periudhë një vjeçare dhe 50 % e pagës për gjashtë muajt e parë të vitit pasardhës.

Faza e dytë:

Përgatitja e kushteve për privatizimin e kompanisë, proces ky që kërkon mbështetje efektive në këto drejtime kryesore:

a. Asistencë teknike të Bankës Botërore për përgatitjen e kuadrit ligjor për fillimin e këtij procesi deri në fund të vitit 2000.

b. Auditim të kompanisë me asistencën e donatorëve të huaj, brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2000.

c. Përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të formulës së privatizimit, të ligjit përkatës dhe të akteve të tjera nënligjore për privatizimin deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2001.

Gjatë fazës së ristrukturimit dhe përgatitjes për privatizim, INSIG-u do të marrë dhe zbatojë disa masa efektive siç janë:

1. Krijimi i një pozicioni aktiv ndaj klientëve në treg , nëpërmjet zbatimit të një sistemi shitjeje me bazë komerciale, duke shfrytëzuar infrastrukturën e ngritur gjë e cila nuk kërkon asnjë lloj investimi paraprak , si edhe duke u dhenë degëve funksione prioritare marketingu. Në ndryshimin e këtij pozicioni, rol jo të vogël do të luajë zbatimi i një marketingu agresiv sidomos në kushtet e konkurencës.
2. Përmirësimi rrënjësor i cilësisë së shërbimit ndaj klientëve , nëpërmjet përmirësimit të skemave të administrimit të dëmshpërblimeve, ofrimit të një game të gjerë të produkteve dhe shërbimeve, zbatimit të formave të reja të komunikimit me klientët në bazë të një kodi etik e profesional.
3. Nxitja e motivimit profesional nëpërmjet vlerësimit analitik të vendeve të punës (job descriptions), zbatimit të një programi trajnues në përputhje me objektivat e kompanisë, si edhe i përdorimit me efikasitet të sistemit ekzistues të shpërblimeve e lidhur ngushtë kjo me kontributin profesional të gjithësecilit.
4. Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve nëpërmjet diversifikimit të mëtejshëm të portofolit të depozitave bankare, shfrytëzimit të mundësive në projekte të përbashkëta investuese, investimeve në tregun e pasurive të paluajtshme , si troje, ndertesa, etj.
5. Vendosja e një sistemi informacioni modern nëpërmjët rinovimit të hardware, vendosjes së postës elektronike, lidhjes me internet si edhe përgatitjes për blerjen e software.

VENDIM
Nr. 64, datë 24.2.2000

PËR KRIJIMIN E SEKTORIT TË POLICISË, PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE DHE TË MUNICIONEVE LUFTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr.8388, datë 5.8.1998, "Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake", ndryshuar me ligjin nr. 8522, datë 9.9.1999, të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999, "Për policinë e shtetit", dhe të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, " Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit te shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Në Ministrinë e Rendit Publik, ne varësi të drejtorit të përgjithshëm të policisë, krijohet sektori i grumbullimit të armëve dhe të municioneve luftarake. Ky sektor ka në varësi strukturat respektive në bazë. Struktura dhe përbërja organike e këtij sektori është sipas lidhjes, nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Struktura dhe përbërja organike e sektorëve për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake në drejtoritë e policisë në prefektura e komisariatet e policisë, përcaktohen nga ministri i Rendit Publik.

2. Punonjësit e policisë së sektorit për grumbullimin e armëve janë pjesë përbërëse e policisë së shtetit. Marrja në punë e tyre bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999, " Për policinë e shtetit", në bazë të kontratës individuale, fillimisht të vlefshme për vitin 2000, me të drejtë përsëritjeje deri në përfundimin e këtij shërbimi.

3. Trajtimi ekomomik e financiar i efektivave të policisë për grumbullimin e armëve është i njëjtë me atë të policisë së shtetit.

4. Transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, të grumbulluara të bëhet me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik, për vitin 2000, shtohet një fond, i cili përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, prej 150 milionë lekësh.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lidhja nr.1

Struktura dhe përbërja organike e Sektorit të Policisë për grumbullimin e armëve në Ministrinë e Rendit Publik

1. Shef Sektori		Oficer 1 (një)
2. Inspektor	Oficer	4 (katër)
		Shuma 5 (pesë)

VENDIM
Nr. 65, datë 24.2.2000

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 433, DATE 9.9.1999 " PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS FUSHË – KRUJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" (ndryshuar me akte të tjera ligjore), dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 31.8.1999 "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 9.9.1999 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa :

1. Shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

Trajtimi i detyrimeve debitore dhe kreditore do të bëhet sipas kapitullit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, date 20.3.1998.

2. Pika 4 ndryshon si vijon:

Kriteret bazë të përzgjedhjes të ofertave do të jenë:

a. Pjesëmarrësit në tender të ketë eksperiencë të drejtëpërdrejtë në prodhimin e çimentos jo më pak se 10 vjet.

b. Pjesëmarrësi në tender të jetë prodhues i çimentos me një prodhimtari mesatare vjetore, në 3 vitet e fundit, jo më pak se 7 milionë tonë në vit.

Pjesëmarrësit në tender, së bashku me ofertën, duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton :

- Aktet e regjistrimit, ose ekuivalentët me to, të çertifikuara jo më pak se 60 ditë nga data e paraqitjes të tyre.
- Bilancin kontabël të audituar të paktën 3 vitet e fundit të aktivitetit.
- Raportin e auditorëve të huaj për 3 vitet e fundit.
- Një përshkrim të aktiviteteve kryesore në fushën e prodhimit të çimentos.

c) Vlerësimet e ofertave të përzgjedhura janë:

i) Niveli i investimit të propozuar	35 pikë
ii) Programi special për punësimin	10 pikë
iii) Mbrojtje e mjedisit	5 pikë
iv) Çmimi i ofruar	50 pikë

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr.66, datë 24.2.2000

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 8237, datë 1.9.1997, "Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare"", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore të jetë:

- për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme, tre anëtarë;
- për shoqëritë e sektorëve strategjikë, me rëndësi të veçantë, deri në gjashtë anëtarë.

2. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime duhet të jenë nëpunës të institucioneve shtetërore, qëndrore dhe vendore, kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera.

Në këshillat mbikëqyrës mund të emërohen edhe punonjës të bankave, të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, si dhe personat që gëzojnë autoritet në fusha të caktuara.

Nuk mund të emërohen anëtar të këshillave mbikëqyrës, punonjës të organeve qendrore a vendore, që kryejnë funksione kontroll–revizioni, punonjës që janë emëruar në drejtoritë e shoqërive tregtare ose janë drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, persona që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin e dytë të kësaj pike.

Pjesëmarrja në këshillin mbikëqyrës do të bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 107, të ligjit " Për shoqëritë tregtare".

3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë:

- Shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, për kryetarin në masën 30 për qind e pagës mujore të drejtorit të shoqërisë, dhe në masën 20 për qind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës.
- Shpërblim për shpërblime a detyra që u besohen anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nga këshilli, nga kryetari i këshillit apo nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Masa e shpërblimit miratohet nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me propozimin e këshillit mbikqyrës.

4. Shpërblim i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës eshte mujor. Ai fillon nga mbledhja e parë e tij dhe përballohet nga vetë shoqëria anonime.

Në mbledhjen e parë zgjidhet kryetari, nënkryetari, sekretari i këshillit mbikëqyrës dhe caktohet masa e shpërblimit për sekretarin.

Këshilli mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit.

5. Këshilli mbikëqyrës i raporton ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në drejtorinë e administrimit të pronës publike, me cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore 4 herë në vit, për veprimtarinë financiare të shoqërisë.

6. Në pikën 1, rreshti i dytë i vendimit nr.720, datë 29.11.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore" hiqen fjalët " këshilla mbikëqyrës".

7. Vendimet nr.279, datë 9.5.1998 dhe nr.478, datë 20.10.1999, të Këshillit të Ministrave, si dhe akte të tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

8. Ngarkohet ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 77, datë 2.3.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.775, DATË 28.10. 1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.775, datë 28. 10. 1996, të Këshillit të Ministrave ndryshohet si vijon:
"Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) përbëhet nga 10 anëtarë:

Kryeministri	kryetar
Ministri i Punëve Publike	zv.kryetar
Ministri i Pushtetit Lokal	anëtar
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtar
Ministri i Ekonomisë dhe Privatizimit	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Transportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	anëtar
Kryetari i Komitetit për Zhvillimin e Turizmit	anëtar

2. Vendimin nr.664, datë 18. 10. 1998, i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.775, datë 28.10.1996, "Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit"", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 90, datë 24.2.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAJISJEN ME PASAPORTA DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMI" DHE TË VENDIMIT NR. 81, DATË 18.2.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 3 të shtohen këto paragrafe:

"- Avokati i popullit

- Prefektët

- Drejtori i kabinetit dhe këshilltarët e zëvendëskryeministrit

- Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve ndërparlamentare dhe drejtori i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërparlamentare në Kuvend.

- Ish nënkryetarët e Kuvendit, për një periudhë 5-vjeçare pas mbarimit të funksionit.

- Në paragrafin e shtatë fjalët "të mitur deri në 18 vjeç", shfuqizohen"".

Në pikën 4 shtohen këto paragrafe:

"– Oficerët e Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues të Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare dhe të Ministrisë së Rendit Publik, pranë institucioneve të huaja homologe.

- Shoferët e zëvendëskryetarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- Drejtori i Zyrës së Administrimit të Buxhetit gjyqësor.

- Drejtori i përgjithshëm i Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare

- Drejtori i përgjithshëm i Hidrokarbureve.

- Drejtori i përgjithshëm i Koorporatës së Kromit.

- Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik.

- Drejtori i përgjithshëm i Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit dhe nënprodukteve të tyre.

- Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit.".

- Kontrolli i Lartë i Shtetit trajtohet si ministri dhe pikat që kanë të bëjnë me Kontrollin e lartë të Shtetit në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, shfuqizohen.

3. Me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme mund të pajisen me pasaporta shërbimi biznesmenë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me një udhëzim të përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme, ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe ministrit të Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 96, datë 9.3.2000

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 121, datë 18.3.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.581, DATË 8.12.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE, PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË ANONIME "AMC""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", dhe të nenit 3, pika 1 dhe 5, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999, "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communication" (AMC)", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 581, datë 8.12.1999, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1, të shtohet pika 1.2, me këtë përmbajtje:

"Duke patur parasysh interesin publik, për nxitjen e investimeve të kompanive të speicializuara në sistemin kombëtar të telekomunikacionit, përqindja e aksioneve të kapitalit, që u ofrohen investitorëve strategjikë, është 85 për qind".

2. Ngarkohet Ministria e ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TË RRETHIT TË DIBRËS

Kërkuese: Lirie Qoku, e bija e Faslliut dhe e Naxhisë, lindur në vitin 1962 në fshatin Bllatë e Epër dhe banuese në qytetin e Peshkopisë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim, Dashamir Qokut, i biri i Shuipit dhe Nasfies, lindur në vitin 1963 në fshatin Kllopçisht dhe banues në qytetin e Peshkopisë, në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Në vitin 1992 kam lidhur martesë me Dashamir Qokun dhe nga kjo martesë kam lindur një vajzë me emrin Irida në vitin 1995. Më 9.3.1996 Dashamiri u nis për në Itali bashkë me disa dibranë të tjerë. Të gjithë personat që ishin në këtë traget, deri më sot nuk janë bërë të gjallë. Kemi bërë të gjitha përpjekjet si me shtetin tonë, edhe me shtetet fqinj (Itali, Greqi, etj), por asnjë shpresë nuk kemi që ata jetojnë.

Në këto kushte, kërkoj që të deklarohet i zhdukur bashkëshorti im Dashamir Qoku.

KËRKUESJA
Lirie Qoku

KËRKESË

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT DURRËS

Kërkuese: Mereme Kila, banuese në lagjen nr.12, rruga "Koço Kazanxhi", nr.703, Durrës.

Objekti: Shpalljen të vdekur të djalit tim Gentjan Kujtim Dervishi, në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Djali im Gentjan Dervishi, i datëlindjes 3. 5. 1973, banues në lagjen nr.12 të qytetit të Durrësit, ka qënë në Itali dhe ka blerë atje anijen "Guja". Më 3. 10. 1997, duke qënë të rimorkiuar nga anija "Erzeni", Gentjani së bashku me shokun e tij Arben Rada janë nisur nga brigjet e Italisë për të ardhur në Durrës.Në afërsi të bregdetit shqiptar, rreth 15 milje, nga një fortunal i fortë në det është këputur cima që lidhte anijen "Guja"me anijen "Erzeni" dhe si përfundim anija "Guja" është zhdukur në det së bashku me dy personat e mësipërm. Kanë kaluar 2 vjet dhe as anija, as Gentjani dhe shoku i tij Arbeni nuk janë gjetur të mbytur dhe nuk kanë dalë në breg. Që nga kjo kohë e deri më sot nuk kemi asnjë njoftim apo të dhënë që të vërtetojë se djali im është gjallë.

Në këto kushte, kërkoj që të shpallet i vdekur djali im Gentjan Kujtim Dervishi.

KËRKUESJA
Mereme Kila

U dorëzua për shtyp më 3.4.2000
Doli nga shtypi më 5.4.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë